

**KUVENDI I KOMUNËS
PRISHTINË**

Me _____

Nr _____

R R E G U L L O R E

PËR

TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE

**KUVENDI I KOMUNËS
PRISHTINË**

Sipas Seksionit 39 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, sipas DAL/AQF, Udhëzimi Administrativ nr. 2001/2-2001/3 për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 dhe caktimin e tarifave, ngarkesave dhe llojet e të hyrave komunale dhe sipas nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me qëllim të krijimit të taksave dhe ngarkesave komunale për sigurimin dhe kryerjen e shërbimeve komunale, në mbledhjen e mbajtur me dat. 28.03.2002, miraton këtë:

R R E G U L L O R E PËR TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.

NENI 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret mbi obliguesin, lartësinë, mënyrën e ngarkesës-llogaritjes, mënyrën e arkëtimit, afatin e pagesës, mbikqyrjen inspektuese, evidentimin, dispozitat ndëshkuese si dhe ankesat në ngarkesat e parapara në vazhdim të kësaj Rregulloreje.

NENI 2

Bartës të obligimeve janë personat fizik dhe juridik

- 2.1. Personat të cilët paraqesin kërkesë për certifikata të ndryshme, vërtetime apo deklarata të cilat lëshohen nga drejtoritë Komunale
- 2.2. Personat juridik dhe fizik të cilët bëjnë procesimin e kërkesave të tyre për regjistrimin e bizneseve;
- 2.3. Personat/Subjekte afariste dhe profesionalistët që kërkojnë marrjen e lejeve të biznesit, lejet profesionale të punës dhe leje të tjera specifike;
- 2.4. Personat/Subjekte afariste që kërkojnë marrjen e lejes për mjetet motorike.
- 2.5. Persona të cilët bartet prona përmes transaksioneve ;
- 2.6. Personat të cilët janë shfrytëzues të përkohshëm të tokës dhe pronës me ndërtime dhe pa ndërtime;
- 2.7. Subjektet apo personat të cilët organizojnë manifestime sportive dhe kulturore
- 2.8. Subjektet fizik apo juridik për ndërtimin e ndërtesave individuale banesore, banesave kolektive dhe hapsirave afariste ;
- 2.9. Subjektet apo personat tek të cilët kryhet inspektimi i përshtuar në tarifën përkatëse ;
- 2.10. Subjektet të cilët mirrën me shfrytëzimin e resurseve natyrore të parapara me tarifën përkatëse :

- 2.11 Subjektet apo personat të cilët paraqiten pronar mbajtës të shtazëvë dhe kafshëvë tjera përgdhelëse ;
- 2.12. Subjektet apo personat të cilët kërkojnë nga drejtoria gjeodete shërbime sipas tarifës së përcaktuar ;
- 2.13. Subjektet apo personat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike për biznese dhe parkingje sipas tarifave përkatëse ;
- 2.14. Subjektet apo personat të cilët bëjnë ekspozimin publik të vitrinave reklamuese apo panove reklamuese si dhe organizimin e lojrave argëtuese të fatit dhe lojrave automatike si dhe rekuizitave tjera sportive sipas tarifave përkatëse.
- 2.15. personat që paraqesin kërkesë për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike,**
- 2.16. personat që paraqesin kërkesë për leje ndërtimore,**
- 2.17. personat që paraqesin kërkesë për leje përdorimi,**

NENI 3.

Lartësia e shumës për kërkesë për dhënjen e certifikatës, deklaratës, vërtetimit, liçencës për biznese, rentave, leje ndërtimore , kompenzimeve për inspektime dhe pagesa të tjera përcaktohen me tarifa përkatëse të cilat janë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

NENI 4.

Tarifat e subjekteve caktohen sipas kësaj Rregulloreje, me aktvendime të Drejtorateve sipas kërkesave të paraqitura.

Në mbështetje të kësaj Rregullore, neni 4, Drejtoratet përkatëse do të nxjerrin aktvendime për për kategoritë lidhur me liçencën e taksave për biznese si dhe për regjistrimin e transaksioneve të pronës si dhe në raste tjera kur paraqitet nëvoja.

Për ngarkesa të tjera obligimet llogariten dhe paguhen me rastin e dorëzimit të kërkesës nga ana e subjekteve të ndryshme.

NENI 5.

Subjektet tarifën e caktuar në bazë të vendimit përkatës, do të paguajnë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përgjashtimishtë nga aline a1. e këtij neni, ngarkesat e caktuara për liçencimin e firmave dhe të tatimit në pronën e qytetarëve dhe personave juridik do të paguhen në 2 kiste të barabarta dhe atë : Kisti i parë gjerë me 15 Maj dhe kisti i 2 gjerë me 15 Nëntor.

NENI 6.

Nëse obligimet e caktuara me vendim nuk paguhen brenda afatit të caktuar sipas nenit paraprak, ndëshkimet do të aplikohen në bazë të nenit 15 të kësaj Rregulloreje.

NENI 7.

Në rast të mospagesës së taksës komuna do të veprojë sipas dispozitave ligjore, duke shfrytëzuar të drejtën e paraqitjes në gjyq.

NENI 8.

Drejtoritë përkatëse komunale për ngarkesat dhe pagesat sipas kësaj Rregulloreje do të mbajnë evidenca në harmoni me dispozitat përkatëse ligjore .

NENI 9

Për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje, në kuader të autorizimeve të veta kujdesen drejtoritë përkatëse

Nëse gjatë punës së tyre, drejtoratet hasin në parregullsi, do të bëjnë përpjekje për t'i evituar ato dhe do të bëjnë propozime përkatëse për eliminimin e këtyre parregullsive. Këto punë drejtoratet do ti kryejnë përmes personave zyrtar.

NENI 10

Obliguesit duhet ti paguajnë ngarkesat dhe taksat sipas Rregullores Komunale në llogaritë përkatëse të komunës drejtëpërsëdrejti në arkë ose përmes bankave afariste.

ANKESAT DHE MBROJTJA GJYQËSORE

NENI 11

Personi mund të bëjë ankesë ndaj vendimit të lëshuar nga komuna nëse ai ose ajo deklaron se i janë shkelur të drejtat e tij. Procedura e ankesës duhet të jetë në pajtueshmëri me procedurën e referuar në Sektorin 35. të Rregullores 2000/45 mbi vetqeverisjen e komunave të Kosovës.

NENI 12

Personi mund të kërkoj ndihmë nga gjyqi, ndaj vendimit të marë nga komuna, në harmoni me rregullat dhe procedurat e gjykatës përkatëse të ligjit të aplikuar.

DISPOZITAT NDËSHKUESE

NENI 13

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, për pesëmbëdhjet ditët vijuese nuk do të aplikohen masat ndëshkuese.

NENI 14

Të gjitha subjektet ekonomike, shfrytëzuesit e hapsirave publike dhe personat tjerë të cilët sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje janë obligues të ngarkesave të parapara, obligohen që afatin brenda 15 ditësh nga dita e publikimit të kësaj Rregulloreje të bëjnë paraqitjen e obligimeve të tyre, kërkesën për lejën e punës nëse me leje nuk disponon, të bëjë kërkesën për marjen e lejës për shfrytëzimin e hapsirave publike dhe të paraqes akte të tjera në pajtushmëri me këtë Rregullore .

NENI 15

Nëse personi nuk e përmbush obligimin gjatë afatit të caktuar me vendim, interesi prej 36 % për vit do të jetë i aplikueshëm. Sidoqoftë shuma totale nuk do të tejkaloj 150 % të taksës së aplikuar.

NENI 16

Personat juridik apo fizik të cilët gjatë punëve ndërtimore kanë dëmtuar rrugët apo hapsirat tjera publike, janë të obliguar të evitojnë dëmin e shkaktuar në afat mbrenda 5 ditësh e nëse këte nuk e bëjnë, gjobiten në shumën sipas dëmit të shkaktuar.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

NENI 17

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është pasqyra tabelare e tarifave dhe ngarkesave të shprehura në EURO.

NENI 18

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon aplikimi i Rregulloreve lidhur me taksat dhe ngarkesat komunale që kanë qenë në fuqi gjerë më tani.

NENI 19

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të nga Kuvendi i Komunës.

PASQYRA TABELARE E TARIFAVE DHE NGARKESAVE TJERA TE SHPREHURA NË EURO.

Detajet e taksave dhe ngarkesave.

01.1. Tarifat e ndryshme për dhënjën e dokumentit zyrtar

| | | |
|----------|--|---------|
| 01.1.10 | Çertifikata e lindjës | 1 EURO |
| 01.1.11. | Çetrifikatë e martesës | 1 EURO |
| 01.1.12. | Çertifikatë e vdekjës. | 1 EURO |
| 01.1.13. | Çertifikata e gjendjes martesore..... | 1 EURO |
| 01.1.14. | Çertifikata për personin që është i gjallë | 1 EURO |
| 01.1.15. | Procedura e kurorizimit..... | 2 EURO |
| 01.1.16. | Ceremonia e martesës | 15 EURO |
| 01.1.17. | Çertifikata të tjera..... | 2 EURO |

Vërejtje:Tarifa paguhet me rastin e paraqitjes së kërkesës.

Pa dëshmi mbi pagesën e tarifës nuk mundë të dorëzohet
Dokumenti i kërkuar.

01-2 NGARKESAT E NDRYSHME

| | | |
|---------|--|--------|
| 01.2.20 | Deklarata me dy dëshmitar..... | 2 EURO |
| 01.2.21 | Deklarata mbi bashkësinë familjare..... | 2 EURO |
| 01.2.22 | Vërtetimi i fotokopjeve (1 faqe)..... | 1 EURO |
| 01.2.23 | Vëretimi mbi mjetet për jetesë..... | 3 EURO |
| 01.2.24 | Ratifikimet (Vërtetimet)..... | 1 EURO |
| 01.2.30 | Deklarata apo vërtetimet tjera si dhe çertifikata mbi Gjendjen ekonomike etj..... | 3 EURO |

Vërejtje: Tarifa paguhet me rastin e paraqitjes së kërkesës.

Pa dëshmi mbi pagesën e tarifa nuk mund të
Dorëzohet dokumenti i kërkuar.

02.0 LIÇENCË NË BIZNESE

02.1.1 Për liçencimin e firmës në subjekte afariste caktohet tarifa për veprimtaritë
:

65.11 Bankat dhe Agjencit Financiare si dhe Shoqerit aksionare per
transaksione
financiare.

64.11 Veprimtarite e komunikimit postal dhe telefonik si dhe sherbimet
private telefoniko-postale.

92.71 Llotarit dhe lojrat e fatit.

NDERMARRJET – KOMPANITË PER EXPORT-IMPORT

51.20, 51.40, 51.50, 51.60,51.70, (sintetika). Tregtija me shumicë dhe përfaqësitë e tyre

afariste (Perpos tregtise se mallrave ushqimore)

51.51 Tregtija me shumicë dhe pakicë e derivateve të naftës dhe përfaqësitë e tyre

afariste.

92.52 Tregtija komisionare

51.46 Tregtija dhe qarkullimi i barneve me shumicë.

55.30 Ndermarrjet e shërbimeve hoteliere

63.40 Ndermarrjet dhe agjencite qe meren me ndermjetsime doganore dhe transport dhe agjencionet e shpedicionit

92.33 Organizimi i panairove dhe ekspozitave dhe ndermarrjet e botës së jashtme dhe

perfaqesite e tyre.

66.03 Kompanitë të cilat miren me sigurimin e pasurisë dhe personave.

Njesite afariste te ndermarjeve sipas tarifes 02.2.20 paguajne 30% nga tarifa

baze.

Tarifa vjetore2000

EURO

02.1.2 52.46 Tregtija dhe qarkullimi i barnave me pakicë.

60.22 Komunikacioni rrugor(përpos komunikacionit të qytetit).

62.10 Komunikacioni ajror.

63.30 Agjensitë turistike

70.31 Subjektet te cilat miren me ndermjetsim ne transakcionet e pasurive te palujteshme..

74.20 Ndermarrjet projektuse – profesionale dhe agjencionet Connsalting.

92.11 Ndermarrjet për blerjen dhe distribuimin e filmave.

52.41 Tregtija me pakicë e mallit jo ushqimor

55.30 Restoranet

55.40 Kafiterite. .

02.01 Pylltaria

Njesit afariste te ndermarjeve sipas tarifes 02.0 paguajn 30% nga tarifa baze.

Tarifa vjetore1000 EURO

02.1.3 45.21, 45.33 Subjektet si: Ndërtimtaria, ujësjellsi, tregtia e prodhimeve ushqimore – bujqësore dhe prodhimtaria e prodhimeve nga brumi.

Tarifa vjetore500 EURO

02.1.4 Lejet profesionale si:Mjeket,stomatologet, avokatet dhe sherbimet profesionale.

Tarifa vjetore..... 300 EURO

02.1.5 Sport dhe rekreacion.

Tarifa vjetore 100 EURO

02.1.6 Lokalet e pavarura zejtare si dhe produktionet muzikore për shumëzimin dhe shitjen e audio – video kasetave dhe CD-ve.

Tarifa vjetore150 EURO

02.1.7 Subjektet tjerë të cilët nuk janë përfshirë në pikatë

paraprake.....150 EURO

Vërejtje:Nëse liqencimi i firmës bëhet në gjashtmujoin e parre
Të vitit kalendarik paguhet ngarkesa për tërë vitin .
Nëse liqencimi i firmës bëhet në gjashmujoin e dytë
ngarkesa për atë vit bëhet 50 %

02.1.7.1 Per dhenjen e lejes per pune te lokalit afarist.....25 EURO

Verejtje: Tarifa paguhet me rastin e paraqitjes se kerkeses

02.3.1 Tarifa ne transakcion te prones per parcele (njesi blerese)

02.3.10 Per parcele-njesi.....100 EURO

02.3.11 Per transakcion te bizneseve.....100 EURO

02.3.12 Per transakcion te mjeteve motorike

- Per auto vetura30 EURO

- Per kamion gjere 3,5 t.....50 EURO

- Per kamion 25 t e me teper70 EURO

- Per autobuse.....70 EURO

Vërejtje : Transakcionet të cilat bëhen në trashigimi dhe dhurat
në rendin e parë të trashigimis lirohen nga pagesa e taksës.
pa dëshmin mbi pagesën e taksës sipas kësaj tarife nuk mund
të bëhet bartja e ndryshimeve në librat e drejtorisë përkatëse.

02.4 - RENTAT MBI SHFRYTËZIMIN E PËRKOHSHËM TË TOKËS DHE PRONËS KOMUNALE

02.4.1 Rentat nga toka me shfrytëzim të përkohshëm pa ndërtime plotësuese caktohet.

- Tarifa vjetore.....3 EURO m²
- 02.4.2 Rentat nga tokat me shfrytëzim të përkohshëm për destinim të caktuar afarist caktohet
Tarifa vjetore2EUROm²
- 02.5 Renta mbi shfrytezimin e tokes urbane me karakter te perhershem.**
- 02.5.1 Rentat per shfrytezimin e tokes urbane ne ndertimin e ndertesave individuale
Tarifa vjetore.....0.30 EURO per m2.
- 02.5.2 Renta per shfrytezimin e tokes urbane ne ndertimin e lokaleve afariste-komerciale
Tarifa vjetore.....5 EURO per m2
- 02.6 Rentat mbi shfrytezimin e tokes me karakter te perkohshem ne zonen industriale.**
- 02.6.1 Toka pa ndertime plotesuese .
Tarifa vjetore.....3 EURO per m2
- 02.6.2 Toka me ndertime plotesuese te karakterit te perkohshem.
Tarifa vjetore.....5 EURO per m2.
- 02.7 Renta per token urbane me karakter te shfrytezimit te perkohshem.**
- 02.7.1 Toka qe ipet ne shfrytezim per qellime prodhuese industriale.
Tarifa e kontraktuar.
- 02.8 Renta mbi shfrytezimin e tokes urbane me ndertim te perhershem.**
- 02.8.1 Objektet – lokalet afariste qe shfrytezohen nga shrytezuesi i tokes urbane.

Tarifa mujore2 EURO per m2.

02.8.2 Objektet-lokalet afariste qe ipen me qira nga shfrytezuesi i tokes urbane.

Tarifa mujore1 EURO per m2.

02.9 Toka urbane qe shfrytezohe me karakter te perhershem per veprimtarite hoteliere dhe tregtare nga ndermarjet afariste.

Tarifa vjetore1 EURO per m2.

06. 1. TARIFAT PËR NDËRTIMIN E NDËRTESAVE INDIVIDUALE , BANESAVE KOLEKTIVE DHE HAPSIRAVE AFARISTE PËR KOMPENZIMIN E INFRASTRUKTURËS

06.1.1 Tarifat për ndërtimin e ndërtesave individuale , banesave kolektive :

- për zonën I..... 10 EURO /m³
- për zonën II. 8 EURO /m³
- për zonën III. 6 EURO /m³
- për zonën IV. 4 EURO /m³

06.1.2 Kompensimi për ndërtimin e hapsirave afariste është:

- për zonën I..... 20 EURO /m³
- për zonën II. 15 EURO /m³
- për zonën III. 10 EURO /m³
- për zonën IV. 5 EURO /m³

06.1.3 Për shëndrrimin e hapsirës banesore në atë afariste në ndërtesat e vjetra banesore (pa ndërtim-adaptim) kompensimi është:

- për zonën I..... 15 EURO /m³
- për zonën II. 12 EURO /m³
- për zonën III. 8 EURO /m³
- për zonën IV. 5 EURO /m³

- Kompensimi për shëndrrimin e hapsirës banesore në hapsirë afariste në objektet e reja ndërtimore është ndryshimi në mes shkallës së paraparë për zonën përkatëse nga pika 06. 1. 1 dhe 06. 1. 2 të kësaj Rregulloreje.

- Kompensimi për shëndrrimin e hapsirës banesore në hapsirë afariste në objektet kolektive banesore paguhet sipas shkallëve të parapara në pikën 06. 1. 2 të kësaj Rregulloreje.

- Investitori duhet të posedoj lejen ndërtimore për objektin për të cilin bëhet ndryshimi i destinimit

06.1.4. Për mbindërtime dhe shëndrrime të hapsirave të përbashkëta në hapsirë banesore mbi objektet kolektive banesore, kompenzimi për rregullimin e tokës ndërtimore është:

- për zonën I..... 20 EURO /m³
- për zonën II.15 EURO /m³
- për zonën III.12 EURO /m³
- për zonën IV.5 EURO /m³

06.1.5 Aneksndërtimi, (zgjerimi i objektit egzistues) dhe mbindërtimi në objektin individual ndërtimor, në kuptim të kësaj Rregulloreje, konsiderohet ndërtim i ri, andaj kompenzimi caktohet sipas shkallëve dhe kritereve të parapara për ndërtimin e objekteve të reja.

(Garazhë në kuptim të kësaj Rregulloreje kuptohet neto sipërfaqja maksimale prej 18 m².)

- Për shëndrrimin e hapsirave të bodrumeve, dhe të hapsirave të tjera të përbashkëta në objektet kolektive banesore, në hapsirë banesore, kompenzimi paguhet sipas shkallës së paraparë nga pika 06. 1. 1 kësaj Rregulloreje.

- Për shëndrrimin e hapsirave të bodrumeve dhe të hapsirave të tjera në hapsira afariste, kompenzimi paguhet sipas shkallës së paraparë nga pika 06. 1. 2 e kësaj Rregulloreje.

- Për shëndrrimin e hapsirës afariste në hapsirë banesore, kompenzimi për rregullimin e tokës ndërtimore paguhet sipas shkallës së paraparë me pikën 06. 1. 1 të kësaj Rregulloreje

06.1. 6 Kompenzimi për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin banesor individual dhe kolektiv në lagjete reja komplekse të urbanizuara, përcaktohet veç e veç për ç`do kompleks banesor.

Bazë për llogaritjen e kompenzimit është shuma e përgjithëshme e shpenzimeve për pregaditjen dhe nevojën e infrastrukturës së lagjës në tërësi i pjesëtuar me numrin e njesive ndërtimore

06. 2. 0 NDËRTIMI I OBJEKTEVE INDUSTRIALE DHE OBJEKTEVE EKONOMIKE

06. 2. 1 Për ndërtimin e objekteve industriale dhe objekteve ekonomike kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore behet ne baze te kontrates.

- Varësisht nga shkalla e paisjes së tokës ndërtimore dhe pozita e saj ndaj qendrës së qytetit , Komuna e Prishtinës ndahet në 4 zona dhe ate në zonën e I , II , III dhe IV .
- Zonat ndërtimore janë përcaktuar nga ana e Drejtoratit për Planifikim dhe Urbanizëm dhe kufijt e këtyre zonave janë të përcaktuar nga ky Drejtorat .
- Kufijtë e zonave të përcaktuara me këtë Rregullore aplikohen me rastin e caktimit për të gjitha tarifatat e parapara me vendime të Kuvendit Komunal të Prishtinës.

- Do të zvogëlohet lartësia e kompensimit të paraparë me këtë Rregullore për:

1. Lirim për ndërtimin e objektit të banimit të dëmtuar nga lufta apo faktkeqësitë elementare sipas kategorisë së IV. të dëmtimit;
2. 50% për ndërtimin e objekteve banesore në themele të vjetra;

Investitori nga. pika 1, 2 dhe 3 mund të gëzoj të drejtën e zvogëlimit të kompensimit vetëm kur bënë ndërtimin në lokacion, gabarit, etazhitet dhe destinim parapark të objektit të dëmtuar.

Investitori gëzon të drejtën e zvogëlimit vetëm kur posedon lejen paraprake apo provën tjetër mbi egzistimin e objektit parapark në kopjen e planit dhe fletën poseduese.

- Mund të lirohen nga pagësa tarifore për rregullimin e tokës ndërtimore investitorët të karakterit social , shëndetsor , arsimor fetar dhe ndonjë investitor tjetër me interes të përgjithshëm shoqëror , por krejt kjo duhet të rregullohet me kontratë nga ana e Komunës së Prishtinës .

- Shkalla e kategorisë së dëmtimit të objektit banesor , përcaktohet nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës .
- Pagesa e kompensimit sipas kësaj Rregulloreje bëhet pas dorëzimit të aktit mbi llogaritjen e kompensimit nga organi përgjegjës Komunal.
- Organi përgjegjës për llogaritjen e kompensimit sipas kësaj Rregulloreje, është Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Nuk mund të dorëzohet leja ndërtimore e kërkuar pa provën mbi pagesën e kompensimit të llogaritur sipas kësaj Rregulloreje për të cilën pagesë është kompetentë Drejtorati për Ekonomi dhe Financa .

- Llogaritja e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore sipas kësaj Rregulloreje bëhet sipas sipërfaqës neto në m³ të objektit ndërtimor.

06.3.0. për paraqitjen e kërkesave për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike
tarifa 10 EURO

06.3.1. për paraqitjen e kërkesave për leje ndërtimore
tarifa 10 EURO.

06.3.2. për paraqitjen e kërkesave për leje përdorimi
Tarifa 10 EURO

07.1 Tarifat inspektuese

07.1.1 Inspektimi veterinar për kafshë të trasha, si p.sh. lopët, kuajt etj.
Tarifa5 EURO

07.1.2 Inspektimi veterinar për kafshë të imta, si p.sh. delet, dhitë, qentë, macat etj.
Tarifa..... 1 EURO

07.2.1 Vërtetim i lëshuar për kafshë të imta nga stacioni i veterinarës,
Tarifa 1 EURO

Nga mjetet e mbledhura nga numri pika 07.1.1 dhe 07.1.2 Veterinarës i takojnë50 %

07.2.2. Pëlqimi mbi plotësimin e kushteve minimale tekniko – sanitare – higjienike dhe mbrojtjes në punë, për 1 m², caktohet:

Tarifa për lokalin gjer më 30 m² 75 EURO
dhe për çdo m² më tepër2 EURO

Vërejtje:Të gjitha këto ngarkesa paguhen me rastin e parashtrimit të Kërkesës.Pa dëshmin mbi pagesën e taksës së përcaktuar Nuk mundë ti lëshohet dokumenti përkatës i kërkuar.

07.3.1. Ngarkesa për Demolimin e ndërtimit të pa autorizuar .

Tarifa.....13 EURO /m².

07.3.2. Ngarkesa për rregullimin e pronës pas Demolimit të ndërtimit të paautorizuar .

Tarifa.....8 EURO/m²
Vërejtje:

Nëse shpenzimet e Demolimit nga pika 07.3.1 dhe 07.3.2 janë më të mëdha atëherë duhet të formohet komisioni për kalkulimin mbi shpenzimet e Demolimit .

Shpenzimet e demolimit bien në barë të investitorit i cili nuk ka Patur leje për ndërtim nga drejtoria e autorizuar komunale.

08. 1. – Ngarkesat nga resurset natyrore si rërë, gurrë dhe bimë të egra pyjore.

08. 1.1 - Kompanitë të cilat resurset natyrore i përdorin për përfitim caktohet

Tarifa vjetore.....2000 EURO

08. 1.2 Shëndrimi i tokës bujqësore në tokë jo bujqësore

Tarifa është2 EURO / m².

09.1 - Ngarkesat e rilevimit të tokës dhe ngarkesat tjera Gjeodezike

Per tarifat te cilat bien ne kundershtim me rregullativen e autoriteteve qendrore Dhe të tarifave te agjencionit kadastral të Kosovës, atehere perdoren tarifat e agjencionit kadastral dhe te autoriteteve qendrore.

09.1.1 - Identifikimi i ngastres me daljen në teren 35 EURO

09.1.2 - Ndërrimi i kulturës kadastrale pa dalje në teren10 EURO

09.1.3 - Ndërimi i kulturës kadastrale në teran me tarifën e matjes50 EURO

09.1.4 - Ndarja e ngastrave nga gjendja faktike

Tarifa e aplikuar per l. ngaster të re50 EURO.

Ndarja me kusht {sipërfaqja e caktuar} për l ngaster të re75 EURO

09.1.5 - Rilevimi i objekteve (sipas destinimit të objektit):

Tarifa.....75 EURO

09.1.6-Punët e rilevimit [pikat trigonometrike poliganale, boshtet etj.

Tarifa.....50 EURO

09.1.7 - Përtrirja e kufirit të ngastres [sipas sipërfaqës]

Tarifa.....125 EURO gjerë më 1000 m²

mbi 1000 m² për çdo m²0.10 EURO

09.2- Përpunimi sipas kërkesës së palës (raportet mbi të dhënat që përmbajnë elaborat të rilevimit) , caktohet:

Tarifa për një ngastër 13 EURO

09. 2.1 Punët vecanta gjeodezike [bartja e të dhënave nga plani urbanistik , shenimi i ngastrave ndërtimore, përpunimi i planit të parcelimit] caktohet .

Tarifa për një ngastër.....500 EURO

09. 2.2 Për shënimin e ngastrave ndërtimore për objekte ekonomike dhe objekte të ndërtimit të përbashkët , caktohet:

Tarifa.....250 EURO

09. 2.3 - Shenime në teren i kufirit të eksproprijimit me rivelim caktohet:

Tarifa.....sipas çmimit të ofrimit të shërbimit.

Tarifa për një pik të detajit2 EURO

09. 2.4 - Identifikimi i ngastrave kadastrale dhe objekteve të rrënuara ose të Ndërtuara , ngastrës pa matje etj.

Tarifa për identifikim në plan për një ngastër.....5 EURO

09. 2.5 - Punët tjera gjeodezike.

Përpunimi i skicave për ndërtesa individuale, lokale afariste.

Tarifa për një objekt.....10 EURO

09.3.1 - Përpunimi i skicave të ndarjes së pronave në etazhe.

09.3.2 Tarifa për banesë deri në 50m².....25 EURO

Për çdo metër katror (m²) më tepër1 EURO

09.3.2 - Përpunimi i skicave për ndërtesa individuale, lokale afariste, punëtori, garazha etj.

Tarifa për 50m².....50 EURO

për çdo metër katror (m²) më tepër.....1 EURO

Punët e tjera gjeodezike:

-të gjitha punet nga gjeodezia ingjinerike, përpilimi i planeve të situacionit
elaborete të eksproprijimit dhe punë tjera nga kjo lëmi, llogaritet sipas normës së orës:

-norma për teren.....5 EURO
-norma për zyre.....3 EURO
-norma për figurant.....3 EURO

09.3.3 - Kopja e planit gjeodezik [sipas paraqitjes horizontale, vertikale nga arkivi

Tarifa për format A-4.....35 EURO

09.0.4 - Paraqitja horizontale nga origjinali i punës

Tarifa për format A-4.....5 EURO

09.3.5 - Për shërbimet tjera dhënja e koordinatave , lartësia mbidetare përshkrimi i pozitës së pikës gjeodezike për një pikë .

Tarifa.....4 EURO

Punët të cilët janë në vëllim me te mëdha dhe nuk mund të aplikohet kjo Rregullore, shkohet në kontrate në mes të shërbimit tekniko profesional dhe Drejtorit të këtij Drejtorati.

Për punët që kryhen jashtë sezonës së terrenit prej 15. tetor, gjerë me 15.mars të vitit kalendarik llogaritet shtesa në shërbime për shkak të kushteve të vështira në teren prej 30 %

Vërejtje:Taksat e përcaktuara në pikat e cekura më lartë llogariten Dhe paguhen me rastin e dorëzimit të kërkesës nga ana E personave juridik apo fizik te drejtoria përkatëse. Pa dëshmin mbi taksën e paguar nuk mundë të lëshohen Dokumentet e kërkuara.

10. 1 – Ngarkesat për shfrytëzimin e sipërfaqeve Publike , detyrimi bazë është për shfrytëzimin e m², sipas zonave të qytetit .

10.1.1.- Vendosija e qosheve (kiosqeve) dhe objekteve tjera prej montazhi në të cilat kryhet veprimtaria (tregti, hotelieri) tarifa mujore .

Tarifa mujore sipas zonave :

| | | |
|--------|-------|-------------------------|
| Zona I | | 10 EURO /m ² |
| II | | 8 EURO /m ² |
| III | | 6 EURO /m ² |
| IV | | 4 EURO /m ² |

10.1.2. – Vendosja e paimëve për akullorë dhe paimëve të ngjashme :
Tarifa mujore sipa zonave :

| | | |
|--------|-------|----------------------|
| Zona I | | 15 EURO / per aparat |
| II | | 10 EURO / “ |
| III | | 7 EURO / “ |
| IV | | 5 EURO / “ |

10.1.3. – Vendosja e stendave të hapura dhe lëvizëse për shitjen e librave jo shkollor caktohet tarifa .

Tarifa mujore sipa zonave :

| | | |
|--------|-------|---------|
| Zona I | | 30 EURO |
| II | | 25 EURO |
| III | | 20 EURO |
| IV | | 10 EURO |

10.2.1– Shfrytëzimi i hapsirës para objektit në të cilën kryhet veprimtaria tregtare

Tarifa mujore sipa zonave:

| | | |
|--------|-------|-------------------------|
| Zona I | | 10 EURO /m ² |
| II | | 8 EURO /m ² |
| III | | 6 EURO /m ² |
| IV | | 4 EURO /m ² |

10.2.2. Shfrytëzimi i hapsirës para objektit në të cilën kryhen shërbime hoteliere

| | | |
|--------|-------|--------------------------|
| Zona I | | 10 EURO / m ² |
| II | | 8 EURO / m ² |
| III | | 6 EURO / m ² |
| IV | | 4 EURO / m ² |

10.3.1. Për shfrytëzime tjera të hapsirës publike – ekspozimi dhe deponimi i

mallit, ambalazhi caktohet

Tarifa mujore sipa zonave :

| | | | |
|------|-----|-------|-------------------------|
| Zona | I | | 20 EURO /m ² |
| | II | | 15 EURO /m ² |
| | III | | 10 EURO /m ² |
| | IV | | 5 EURO /m ² |

10.4.0. – Tarifat per automjetet me vendbanim ne Komunen e Prishtines gjegjesisht lejet komunale.

- Per automjete.....25 EURO
- Per kombi-bus.....35 EURO
- Per kamion deri 3.5 t.....80 EURO
- Per kamion 25 t.....100 EURO
- Per autobuse.....100 EURO

10.5.1. – Nga pagesa janë të liruar automjetet e :

Mbrojtjës shëndetsore dhe sociale ,
Organizatave humanitare ,
Organeve shtetore dhe organizatat publike Komunale

Gjithashtu nga pagesat janë të liruar :

Invalidët e ushtark ,
Invalidët civil të luftës dhe
Invalidët e punës.

Pronarët e automjeteve që lirohen nga pagesat janë të detyruar të dëshmojnë arsyen se në çfarë baze e shfrytëzojnë mos pagesën.

10.6.1. – Ngarkesat për marrjen , bartjen dhe magazinimin e automjeteve të parkuara në vende të ndaluara .

Tarifa për çdo automjet10 EURO

(Për ngarkesat nga pika 10.6.1 Komuna do të bëjë kontratë me kompanitë e autorizuar për marrjen , bartjen dhe magazinimin e automjeteve).

10.7. - Ekspozimi publik i vitrinave reklamuese

Sipërfaqe ekspozuese e vitrinës konsiderohet sipërfaqe në të cilën janë të ekspozuara gjërat reklamuese . Ngarkesa paguhet për metër katror të sipërfaqës

së dukshme ku ekspozohet reklamimi .

10.7.1.- Vendosja e vitrinave për ekspozimin e mallit jashtë lokalit afarist,
Tarifa mujore sipas zonave .

| | | |
|--------|-------------|-------------------------|
| Zona I | tarifa | 20 EURO /m ² |
| II | “ | 15 EURO /m ² |
| III | “ | 10 EURO /m ² |
| IV | “ | 5 EURO /m ² |

10.7.2.- Ekspozimi i panove reklamuese

Sipërfaqja ekspozuese e panove reklamuese konsiderohet sipërfaqja në të cilën janë të ekspozuara reklamat për biznes etj. Në qytet apo jashtë qytetit bri rrugës kryesore. Pagesa bëhet për metër katror të sipërfaqës së dukshme nga rruga.

10.7.21. – Ekspozimi i panove reklamuese në qytet

Tarifa vjetore50 EURO /m²

Panot reklamuese me ndriqim paguhen me tarifë të shtuar për 30 % , kurse reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit është e ndaluar.

10.7.22. – Ekspozimi i panove reklamuese jashtë qytetit.

Tarifa vjetore 30 EURO /m²

Ngarkesat sipas kësaj tarife paguhen me rastin e marrjes së lejës për vendosjen e panove reklamuese, për aq kohë sa do të jenë të vendosura panot (pllakatat).

Nëse shfrytëzimi reklamues bëhet me pak se 30 ditë shtohet vlera për 50 %
Nëse pllakata është shumë krahëshe paguhet për çdo krah të dukshëm.

- **Organizatrat që organizojnë manifestime për qëllime humanitare nuk ngarkohen me tarifën e cekura më lartë.**

10.8. 1. – Ngarkesat për organizimin e lodrave argëtuese, të fatit dhe lodrave argëtuese automatike të ndryshme si dhe rekvizeteve tjera sportive paguhet ngarkesa mujore për çdo aparat sipas llojit .

10.8.2. – Për mbajtjen e aparateve për lojra fati që sjellin fitim në para ,
Tarifa mujore.....10 EURO.

10.8.3. – Për mbajtjen e aparateve për lojra argëtuese etj.

Tarifa mujore8 EURO

10.8.4. - Për tavolinë të bilardos

Tarifa mujore.....15 EURO.

Vërejtje:Tarifa sipas pikave të cekura në këtë tarifë paguhen me Rastin e dhënjes së lejes nga drejtorija përkatëse.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Nr. _____ **Dt.** _____

KRYETARI I KUVENDIT

Dr. Salih Gashi